



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/243

Datë: 10.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet përditësimi i Listës Shtetërore Strategjike për Mallra me Përdorim të Dyfishtë, të datës 5 shtator 2024 me Nr. C (2024) 6093, duke iu referuar Listës së Bashkimit Evropian, për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike ose për arsye të drejtave të njeriut, në përputhje me Rregulloren e deleguar të Komisionit të BE-së 2023/2616 të datës 15 shtator 2023, duke ndryshuar Rregulloren e BE-së 2021/821 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, për sa i përket listës së artikujve me përdorim të dyfishtë Nr. 2023/2616, të datës 15 dhjetor 2023.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Institucionet tjera kompetente për zbatim të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/243
Datë: 10.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, nenit 16A paragrafi 3 nën-paragrafi 3.1. të Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-141 dhe Ligjin Nr. 08/L-142, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rritja e përfitimeve dhe pensioneve duke përditësuar tabelën në Shtojcën 1. të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-172 dhe Ligjin Nr. 08/L-219, sipas Aneksit 1. të këtij vendimi.
2. Aprovohet rritja për njëzet për qind (20%) mbi shumën aktuale prej njëqind e shtatëdhjetë euro (170.00€), për pensionet e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
3. Aprovohet rritja për njëzet për qind (20%) për pensionet e viktimave të dhunës seksuale të luftës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Aneksi 1

LARTËSIA E PENSIONEVE	
Pensionet familjare për familjet e Dëshmorëve të UÇK-së	
Familja që e ka dhënë një Dëshmorë:	537.76 €
Familja që i ka dhënë dy Dëshmorë:	806.63 €
Familja që i ka dhënë tre Dëshmorë:	1,075.51 €
Familja që i ka dhënë katër Dëshmorë:	1,344.39 €
Familja që i ka dhënë më shumë se 4 Dëshmorë:	1,613.27 €
Pensionet familjare për familjet e të zhdukurve të UÇK-së	
Familja me një të zhdukur të UÇK-së	537.76 €
Familja me dy të zhdukur të UÇK-së	806.63 €
Familja me tre të zhdukur të UÇK-së	1,075.51 €
Familja me katër të zhdukur të UÇK-së	1,344.39 €
Familja me më shumë se 4 të zhdukur të UÇK-së	1,613.27 €
Pensionet invalidore personale për Invalidët e UÇK-së	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	537.76 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	495.00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	472.50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	450.00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	427.50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	382.50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	270.00 €
Shtesa për përkujdesje dhe ndihmë për Invalidët e UÇK-së	
Kujdestari për Invalidin me dëmtim trupor me mbi 80%	270.00 €
Pensionet familjare pas vdekjes së invalidit të UÇK-së	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	430.20 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	396.00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	378.00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	360.00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	342.00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	306.00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	216.00 €
Pensionet familjare për familjet e Viktimave Civile	
Familja me një viktimë	202.50 €
Familja me dy viktima	303.75 €
Familja me tre viktima	405.00 €
Familja me katër viktima	506.25 €
Familja me më shumë se katër viktima	607.50 €
Pensionet familjare për familjet e të Zhdukurve Civil	
Familja me një të zhdukur civil	202.50 €

Familja me dy të zhdukur civil	303.75 €
Familja me tre të zhdukur civil	405.00 €
Familja me katër të zhdukur civil	506.25 €
Familja me më shumë se katër të zhdukur civil	607.50 €
Penionet invalidore personale për Invalidët Civil të Luftës	
Invalidi me dëmtim trupore mbi 80%	183.00 €
Invalidi me dëmtim trupore mbi 61-80%	163.50 €
Invalidi me dëmtim trupore mbi 40-60%	144.00 €
Shtesa për përkuqdesje dhe ndihmë për Invalidët Civil të Luftës	
Kujdestari për Invalidin me dëmtim trupor me mbi 80%	60.16 €
E drejta në pensionin familjar pas vdekjes së invalidit Civil të Luftës	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	147.90 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 80%	132.30 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 40- 60%	116.70 €



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/243
Datë: 10.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Lyra Osmani, emërohet në pozitën e Inspektorese së Përgjithshme, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
2. Mandati i të emëruarës nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. E emëruara nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/243
Datë: 10.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publik, nenit 16 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Avni Kastrati, emërohet në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/243
Datë: 10.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 43 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti për Vlerësimin Ex - Post të Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha Institucionet tjera që në procesin e ardhshëm të planifikimit legjislativ të marrin parasysh gjetjet dhe rekomandimet e Raportit për Vlerësimin Ex - Post të Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë.
3. Pjesë e këtij vendimi është Raporti për Vlerësimin Ex - Post të Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë.
4. Raporti dërgohet për njoftim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë